

Pershendetje,

Duke ju falenderuar per interesimin tuaj ndaj procesit dhe procedurave qe KED duhet te permbushe ne zbatim te ligjit dhe ne lidhje me kerkesen tuaj derguar prane Gjykates se Larte, protokolluar me nr.427 prot date 07.02.2019, ju sqarojme si me poshte vijon;

Pas me shume se 2 vite e gjysem, KED eshte duke punuar intensivisht per te permbushur kerkesat ligjore duke nisur nga perpilimi dhe miratimi i rregullores se brendshme dhe akteve te tjera qe do te ndihmojne kete keshill te permbushe kompetencat e tij, per te shqyrtuar kandidatet per ne Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Larte te Drejtesise. Ky keshill, ashtu sikurse eshte bere publike edhe ne media, apo me ane te njoftimeve te publikuara ne faqen e internetit te Gjykates se Larte, ne rubriken Keshilli i "Emerimeve ne Drejtesi", eshte ende ne fazen e miratimit te ketyre akteve. Ne keto kushte, ju sqarojme se keshilli nuk ka nisur ende fazen e perzgjedhjes se kandidateve konkurues per vendet vakante ne Gjykatën Kushtetuese dhe ILD. Per kete arsye nuk mund t'ju ndihmojme me listen e kandidateve te kualifikuar dhe te pakualifikuar nga KED per vitin 2019. Sigurisht, qe kjo kerkese do te permbushet nga ana jone, sapo procedura te jete finalizuar.

Ne lidhje me piken 2 te kerkeses, lutemi te na specifikoni, cilet jane, sipas jush, kandidatet e zgjedhur ne KED per vitin 2019?

Presim emailin tuaj, per t'ju sqaruar edhe per kete pike.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin dhe mirekuptimin,

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Keshilli_i_Emerimeve_ne_Drejtesi_11_1.php

Ida Vodica Laska

Shefe e Marredhenieve me Median dhe Publikun
Koordinatorë per te Drejten e Informimit te Gjykates se Larte
(Head of Media and Public Relations Department)

25/3

1377

Pershendetje,

Ne vijim te komunikimit, ju bej me dije se Jeteshkrimet e dy anetareve te KED njekohesisht edhe te Gjykates se Larte, gjenden te publikuara ne faqen zyrtare te kesaj gjykate, qe nga momenti i emerimit te tyre ne kete gjykate.

Klikoni ne linkun e meposhtem:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Anetaret_e_Gjykates_se_Larte_72_1.php

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

Ida Vodica Laska

Shefe e Marredhenieve me Median dhe Publikun
Koordinator e Drejten e Informimit te Gjykates se Larte
(Head of Media and Public Relations Department)